

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 10.3.2020

PËR RREGULLAT DHE MASAT PËR TRAJTIMIN E AMBALAZHEVE DHE PALETAVE PREJ DRURI

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetur në pikën 4, të nenit 11, të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”,

UDHËZOJNË:

1. Trajtimi i ambalazheve dhe paletave prej druri, të kryhet në përputhje me rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që lidhen me mbrojtjen e bimëve dhe pyjet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

**MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Blendi Klosi**

RREGULLAT DHE MASAT PËR TRAJTIMIN E AMBALAZHEVE DHE PALETAVE PREJ DRURI

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë masat fito-sanitare të cilat reduktojnë riskun e hyrjes dhe përhapjes së parazitëve karantinorë, të lidhur me lëvizjen në tregtinë ndërkombëtare të materialeve të paketimit të bëra prej druri të papërpunuar. Ky udhëzim mbi materialet e paketimit prej druri përfshin materialet fiksuese dhe përjashton paketimet e drurit të përbëra nga dru i procesuar në atë mënyrë që sigurojnë pastërti nga parazitët, p.sh. kompensata. Masat fito-sanitare të përshkruara në këtë udhëzim nuk mund të sigurojnë mbrojtje të përhershme nga parazitët kontaminues ose nga organizma të tjerë.

Neni 2 Përkufizimet

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”. Për efekt të këtyre rregullave, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Certifikatë miratimi”, dokument i lëshuar nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) “Doza”, sasia e energjisë rrezatuese e përthithur për njësi të masës së një objekti të caktuar; “Dru i papërpunuar”, druri i cili nuk ka pësuar përpunim ose trajtim;

c) “Dru pa lëvore”, druri prej të cilit lëvorja është hequr, përjashtuar, shtresën e kambiumit, lëvoren që rritet brenda dhe rreth nyjave dhe xhepat lëkurore midis unazave të rritjes vjetore;

ç) “Dru”, kategoria e mallit për drurin e rrumbullakët, drurin e sharruar, ristela ose copëza/ashkla mbështetëse druri, me ose pa lëvore, duke përjashtuar materialet e paketimit të drurit, materialet e përpunuara të drurit dhe produktet e bambusë;

d) “Fumigim”, trajtimi me një agjent/lëndë kimike që e përshkon mallin në tërësi ose në thelb/në zemër të tij, në gjendje të gaztë;

dh) “Infektim”, prania e parazitëve të gjallë në bimë, produkte bimore e objekte të tjera;

e) “Inspektor”, është personi përgjegjës për inspektimet fito-sanitare në PIK;

ë) “IPPC”, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve, e themeluar në vitin 1951;

f) “Lëvore”, shtresa e një trungu druri, dege apo rrënje jashtë shtresës së kambiumit;

g) “Masë emergjente”, një masë ose procedurë fito-sanitare e vendosur në një rast urgjence, në një situatë të re ose të papranueshme fito-sanitare. Një masë emergjence mund të mos jetë një masë e përkohshme;

gj) “Masë fito-sanitare”, masë zyrtare për të parandaluar hyrjen dhe/ose përhapjen e parazitëve karantinorë ose për të kufizuar impaktin ekonomik të parazitëve të rëndësishëm jo-karantinorë, duke përfshirë vendosjen e procedurave për certifikimin fito-sanitar;

h) “Material ambalazhi prej druri”, ose prodhime druri (përjashtuar drurin e hollë me trashësi nën 6 mm dhe produktet prej letre/kartoni), i përdorur për mbështetjen, mbrojtjen ose mbajtjen e një malli (përfshirë drurin mbështetës);

i) “Material drusor i përpunuar”, produkti që ka në përbërje dru të montuar duke përdorur ngjitës, nxehtësi dhe shtypje, ose ndonjë kombinim të tyre;

j) “Materiali fiksues ose mbështetës”, materiali i ambalazhit prej druri i përdorur për të siguruar ose mbështetur një mall, por që nuk mbetet i bashkuar me mallin;

k) “Materiali i paketimit prej druri (MPD)”, materiali i ambalazhit dhe i paletave prej druri, që përdoret të ngarkesat gjatë transportit në formën e arkës, kutisë, kutisë paketuese, materialit fiksues, paletës, çikrikut rrotullues dhe bobinës/rrotullës, duke përjashtuar produktet e letrës;

l) “Monitorimi”, procesi zyrtar i vazhdueshëm për të kontrolluar/inspektuar situatat fito-sanitare;

m) “Ngarkesë”, një sasi bimësh, produktesh bimore dhe/ose objekte të tjera; të cilat lëvizin nga një shtet në tjetrin dhe që përfaqësohen nga një certifikatë fito-sanitare e vetme (një ngarkesë mund të jetë e përbërë nga një ose me shumë lote). Në këto rregulla kuptohet edhe bashkësia e një grupi homogjen malli që lëviz në transport njëherësh dhe që përfaqësohet në një dokument të vetëm veçanërisht kur është i përfshirë në transportin ndërkombëtar;

n) “Njësi”, pjesë druri prej të cilës përbëhet materiali i paketimit prej druri “MPD”;

nj) “Subjekt i prodhimit”, i cili është i kontraktuar nga një operator i miratuar nëpërmjet një marrëveshje, për të kryer prodhimin;

- o) “Subjekt i trajtimit”, i cili është i kontraktuar nga një operator i miratuar nëpërmjet një marrëveshje, për të kryer trajtimin;
- p) “Operator i miratuar”, subjekti i cili është i miratuar për përdorimin e vulës sipas këtij udhëzimi;
- q) “Trajtim me fumigim me *methyl bromide* (MB)”, procesi gjatë të cilit materiali ambalazh prej druri duhet të fumigohet me *methyl bromide*;
- r) “Trajtim me fumigim me *Sulphuryl fluoride* (SF)”, procesi gjatë të cilit materiali ambalazh prej druri duhet të fumigohet me *Sulphuryl fluoride*;
- s) “Trajtim me nxehtë dielektrike (DH)”, procesi gjatë të cilit një mall nxehtë me nxehtësi dielektrike deri sa arrihet një temperaturë minimale në një periudhë minimum kohe;
- t) “Trajtim me nxehtësi (HT)”, procesi gjatë të cilit një mall nxehtë deri sa arrihet një temperaturë minimale në një periudhë minimum kohe;
- th) “Vend origjine”, vendi ku bimët janë rritur e kultivuar për herë të parë;
- u) “Veprim emergjence”, një veprim me karakter fito-sanitar i ndërmarrë në një situatë të re ose të papranueshme fito-sanitare;
- v) “Veprim fito-sanitar”, një veprim zyrtar i tillë si: inspektim, testim, mbikëqyrje ose trajtim, i ndërmarrë me qëllim implementimin e rregullave ose procedurave fito-sanitare;
- x) “Vulë”, një simbol zyrtar, i njohur në nivel ndërkombëtar, që është ndërthurur me kodet identifikuese të vendit prodhues dhe operatorit të miratuar, për të vërtetuar gjendjen e tij fito-sanitare;
- y) “Zhveshje e lëvores”, heqje e lëvores nga druri me formë rrethore, (kjo nuk e bën patjetër drurin pa lëvore).

KREU II

INSPEKTIMI FITO-SANITAR I MATERIALIT TË PAKETIMIT PREJ DRURI DHE PËRJASHTIMET

Neni 3

Procedurat fito-sanitare

Procedura specifike fito-sanitare të përcaktuara në këtë udhëzim garantojnë gjendjen shëndetësore të materialit të paketimit prej druri dhe kontrollin e kësaj gjendjeje në shkëmbimet tregtare të import-eksportit; pacenuar dhe duke zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga neni 14, i ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”.

Neni 4

Rreziku që paraqet materiali i paketimit prej druri

Materiali i paketimit prej druri “MPD”, i bërë nga dru i papërpunuar, i cili mund të mos i jetë nënshtruar procesimeve ose trajtimeve për kontrollin e parazitëve, përbën një mënyrë për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë. Njëkohësisht materialet fiksuese janë burim i një risku të lartë për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë. Materiali i paketimit prej druri mund të jetë i ripërdorur, i riparuar ose riprodhuar sipas përcaktimeve në kreun V, të këtij udhëzimi. Për këtë arsye, ky udhëzim përcakton masa të njohura ndërkombëtarisht të cilat mund të aplikohen te materiali i paketimit prej druri, nga të gjitha vendet, për të reduktuar në mënyrë të rëndësishme riskun e hyrjes dhe përhapjes të shumicës të parazitëve karantinorë.

Neni 5

Objekt inspektimi fito-sanitar

Objekt inspektimi fito-sanitar është çdo material paketimi prej druri, i cili mund të shërbejë si rrezik për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve të bimëve. Materiali i paketimit prej druri përfshin: arkat, kutitë, kutitë paketuuese, materialet fiksuese, paletat, çikrikë rrotullues dhe bobinat/rrotullat, të cilat mund të jenë të pranishme në çdo ngarkesë.

Neni 6

Përfshirjet

Përfshihen nga inspektimi fito-sanitar llojet e paketimit, si më poshtë:

- a) materiali i paketimit prej druri që është bërë plotësisht nga dru i hollë deri në 6 mm;
- b) materiali paketuës i përbërë plotësisht nga material druri, plotësisht i procesuar, siç janë: kompensatat, grimcat e dërrasës, dërrasë me madhësinë e fijes së flokut ose rimeso të cilat janë krijuar duke përdorur ngjitës, nxehtësi ose presion ose kombinimi i këtyre së bashku;
- c) fuçitë e verës dhe pijes, të cilat janë nxehur gjatë prodhimit;
- d) kuti dhuratash për verë, cigare ose mallra të tjerë të përbërë nga dru që është i përpunuar dhe/ose prodhuar në mënyrë të tillë që e bën të pastër nga parazitët;
- e) tallash, copëza druri ose lesh druri;
- f) komponente druri të lidhura gjithmonë me automjetet e mallrave ose kontenerët.

KREU III

MASAT FITO-SANITARE TË MIRATUARA PËR MATERIALIN E PAKETIMIT PREJ DRURI

Neni 7

Masat fito-sanitare të miratuara

1. Ky udhëzim përcakton procedurat dhe masat fito-sanitare duke përfshirë trajtimin dhe vulosjen e materialit të paketimit prej druri. Aplikimi i vullës e bën të panevojshëm përdorimin e certifikatës fito-sanitare meqenëse ajo tregon që janë aplikuar të gjitha masat fito-sanitare të pranura ndërkombëtarisht.

2. Trajtimet e përshkruara në aneksin I, të këtij udhëzimi, janë efektive kundër shumicës së parazitëve që jetojnë në pemë dhe që prekin materialin e paketimit prej druri, të përdorur në tregtinë brenda dhe jashtë vendit, të kombinuara edhe me dru të pazhveshur. Këto masa janë miratuar duke marrë parasysh:

- a) rangun e parazitëve, që mund të preken;
- b) efikasitetin e trajtimit;
- c) realizueshmërinë teknike dhe/ose komerciale.

Neni 8

Aktivitetet, vula dhe druri me lëvore

1. Aktivitetet kryesore, që përfshihen në prodhimin e materialit të paketimit prej druri të miratuar, duke përfshirë materialin fiksues, janë:

- a) trajtimi;

b) prodhimi;

c) vulosja.

2. Aktivitetet e mësipërme, në pikën 1 të këtij neni, mund të bëhen nga një operator i miratuar, ose një operator i miratuar nëpërmjet një marrëveshje, mund të bëjë prodhimin dhe trajtimin në një subjekt ose në subjekte të ndryshëm.

3. Vula e specifikuar sipas pikës 5, nenit 10, kreu IV, të këtij udhëzimi, e njohur ndërkombëtarisht, pa gjuhë specifike, lehtëson identifikimin e materialit të paketimit prej druri të trajtuar, gjatë inspektimeve paraprake nga inspektorët e inspektimit fito-sanitar në PIK.

4. Druri me lëvore mund të përdoret për materialin e paketimit prej druri, pas aplikimit të një prej metodave të miratuara të trajtimeve, duke respektuar tolerancën, sipas aneksit 1, të këtij udhëzimi.

KREU IV

MIRATIMI, PËRDORIMI I VULËS, KONTROLLET DHE REGJISTRI

Neni 9

Miratimi

1. Trajtimi dhe aplikimi i vulës dhe/ose aktiviteve të lidhura sipas pikës 1, të nenit 8, kreu III, të këtij udhëzimi, monitorohen nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB). Shërbimi i mbrojtjes së bimëve miraton operatorin për të bërë procesin e trajtimit dhe përdorimin e vulës pas plotësimit të kushteve të përshkruara në pikën 2, të nenit 10, të këtij kreu.

2. Operatori i cili kërkon të miratohet, duhet të bëjë kërkesën me shkrim pranë ARSHVMB-së, në rajonin përkatës. Pas marrjes së kërkesës shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, paraqet kërkesë të struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve (SPMB) në ministri për t'u pajisur me kodin për këtë operator, para kryerjes së kontrollit.

3. Në rast miratimi të operatorit, Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, e pajis me “certifikatë miratimi” brenda 5 ditëve, sipas modelit në aneksin VI, të këtij udhëzimi.

Neni 10

Përdorimi i vulës

1. Operatori i miratuar që ka në përgjegjësi përdorimin e vulës njihet si prodhues.

2. Të gjithë operatorët që kërkojnë të miratohen duhet të plotësojnë kërkesat e përshkruara në aneksin I, të këtij udhëzimi, sipas procesit të trajtimit.

3. Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, që miraton “operatorin e miratuar” për përdorimin e vulës, siguron që ky operator përmbush të gjitha kërkesat e përshkruara në këtë udhëzim dhe pas çdo miratimi dërgon te SPMB-ja, të dhënat e operatorit të miratuar, si më poshtë:

a) emrin;

b) adresën;

c) kontaktin;

d) kodin e operatorit të miratuar;

e) kodin e trajtimit;

f) datën e miratimit.

Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, nuk duhet të shpërndajë informacionin në lidhje me pikat “a” deri “f”, përveç të SPMB-ja.

4. Të gjithë operatorët e miratuar duhet të përdorin vulën sipas modelit në pikën 2, aneksi II dhe kërkesave të aplikimit të përshkruara në këtë aneks. Të gjitha ngarkesat në import dhe/ose tranzit, të cilat janë të shoqëruar me material sipas nenit 5, kreu II, të këtij udhëzimi, duhet të jenë vulosur me vulë sipas modeleve në pikën 1, aneksi II dhe kërkesave të përshkruara në këtë aneks.

5. Në rastet kur operatori i miratuar kërkon të shtojë një ose më shumë filiale të tjera, ai bën kërkesën të Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, i cili kryen kontrollin, sipas formatit në aneksin IV, të këtij udhëzimi. Nëse plotësohen kushtet sipas pikës 2, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi, kërkesa e tij miratohet dhe pas miratimit, operatori do të përdorë të njëjtën vulë që ka të miratuar herën e parë.

Neni 11 **Kontrolllet**

1. Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, ka përgjegjësi për:

a) kontrollin e operatorit për plotësimin e kriterëve sipas procesit të trajtimit që kërkon të miratohet, referuar pikës 2, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi për miratimin e operatorëve. Gjatë kontrollit plotëson formatin sipas modelit në aneksin IV, të këtij udhëzimi;

b) miratimin dhe dërgimin e të dhënave pranë SPMB-së;

c) kontrollin e operatorit të miratuar nëpërmjet kontrollit me bazë risku, në momentin e kontrollit plotësohet formati sipas modelit në aneksin V, të këtij udhëzimi.

2. Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, mbikëqyr, kontrollon dhe rishikon aktivitetet sipas pikës 1, neni 8, të kreut III të operatorit të miratuar në lidhje me trajtimin e materialit të paketimit prej druri.

3. Trajtimi i materialeve të paketimit prej druri duhet të jetë i plotë para pajisjes me vulë. Për të parandaluar qarkullimin e materialeve të paketimit prej druri që mbajnë vulë, të cilat janë të patrajuara ose të trajtuara jo mjaftueshëm ose në mënyrë jo korrekte, trajtimi duhet të kryhet para aplikimit të vulës.

4. Për materialin e paketimit prej druri, i cili nuk është i trajtuar sipas aneksit I, të këtij udhëzimi dhe/ose vulosur sipas pikës 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi, agronomi i shërbimit të mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, zbaton masat e përcaktuara në pikën 1, neni 18, kreu VI, të këtij udhëzimi.

Neni 12 **Regjistri**

1. Regjistri plotësohet nga operatori i miratuar duke pasqyruar të dhënat e çdo trajtimi të kryer dhe ruhet për 3 vite.

2. Regjistri përmban këto elementë:

a) datën;

b) subjektin e prodhimit;

c) kodin e trajtimit;

d) subjektin e trajtimit;

e) komente (mbi procedurën dhe kohëzgjatjen e trajtimit).

3. Materiali i paketimit prej druri që është trajtuar ose vulosur, sipas këtij udhëzimi, dhe që nuk ka qenë riparuar, riprodhuar ose ndryshuar, nuk kërkon ritrajtim ose riaplikim të vulës.

4. Struktura përgjegjëse e Mbrojtjes së Bimëve, harton një regjistër kombëtar për operatorët e miratuar dhe e publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Neni 13

Lënda drusore

1. Lënda drusore, që përdoret për prodhimin e materialit të paketimit prej druri, duhet të jetë konform legjislacionit në fuqi.

KREU V

MATERIALI I PAKETIMIT PREJ DRURI I RIPËRDORUR, RIPARUAR DHE RIPRODHUAR

Neni 14

Ripërdorimi i materialit të paketimit prej druri

1. Materiali i paketimit prej druri që është trajtuar ose vulosur sipas këtij udhëzimi dhe nuk ka qenë riparuar ose riprodhuar, nuk kërkon ritrajtimin ose rivulosjen për sa kohë që nuk pëson ndryshime.

Neni 15

Materiali i paketimit prej druri, i riparuar

1. Materiali i paketimit prej druri, është ai material që ka pasur afërsisht një të tretën e pjesëve të tij të hequra ose të zëvendësuara. Në këtë rast duhet të sigurohet që materiali i riparuar është vulosur, është përdorur vetëm dru i përpunuar në përputhje me këtë udhëzim ose dru i formuar ose fabrikuar nga material druri i procesuar, sipas nenit 6, kreu II, të këtij udhëzimi. Kur për riparim përdoret dru i trajtuar, çdo njësi që është shtuar duhet të vulozet individualisht në përputhje me këtë udhëzim.

2. Materiali i paketimit prej druri që mban shumë vula mund të krijojë problem në përcaktimin e origjinës së këtij materiali nëse gjenden parazitë në to. Rekomandohet që materialit të paketimit prej druri që, të hiqen vulat e ndryshme që mund të duken në një njësi të materialit dhe t'i nënshtrohet masa fito-sanitare dhe të vulozet sipas kritereve të këtij udhëzimi.

3. Kur për riparim përdoret dru i trajtuar, çdo njësi e shtuar duhet të vulozet individualisht në përputhje me pikën 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi.

4. Kur materiali i paketimit prej druri është riparuar duhen fshirë vula/t e/të mëparshme të ky paketim, të ritrajtohet në përputhje me pikën 3, neni 8, kreu IV, të këtij udhëzimi, si dhe të vulozet në përputhje me pikën 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi.

5. Në kushtet kur ka dyshime që të gjitha njësitë e riparuar të materialit të paketimit prej druri nuk janë trajtuar sipas këtij udhëzimi ose ka vështirësi në konstatimin e vendit të origjinës së njësive të materialit të paketimit prej druri ose komponentëve të tij, vendi ku materiali i paketimit prej druri është riparuar, duhet të kërkojë që ky paketim i riparuar të ritrajtohet, shkatërrohet ose përndryshe të ndalohet nga lëvizja në tregtinë brenda dhe jashtë vendit. Në rast ritrajtimi çdo aplikim i mëparshëm i vulës duhet të zhduket përgjithmonë p.sh, duke e mbuluar me bojë ose bluarje. Pas ritrajtimit, vula duhet aplikuar përsëri në përputhje me pikën 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi.

Neni 16

Materiali i paketimit prej druri të riprodhuar

1. Nëse materiali i paketimit prej druri ka pasur më shumë se një të tretën e njësive të tij të zëvendësuar, ky material paketimi konsiderohet si i riprodhuar. Në këtë proces disa njësi me ripunim shtesë nëse është i nevojshëm mund të kombinohen dhe më pas të bashkohen me material tjetër. Materiali i paketimit prej druri i riprodhuar mund të përfshijë së bashku njësi të reja dhe të mëparshme të përdorura.

2. Materialit të paketimit prej druri të riprodhuar duhet t'i hiqet përfundimisht çdo vulë e aplikuar më parë p.sh. duke i mbuluar me bojë ose bluarje dhe të ritrajtohet në përputhje me pikën 2, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi dhe të vulozet në përputhje me pikën 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi.

KREU VI

PROCEDURA E INSPEKTIMIT NË IMPORT, TRANZIT DHE MASAT FITO-SANITARE NË RAST MOSPËRPUTHJE

Neni 17

Procedura në import dhe tranzit

1. Çdo material i paketimit prej druri i cili plotëson dispozitat e nenit 5, kreu II, të këtij udhëzimi, që shoqëron ngarkesat, është objekt i inspektimit fito-sanitar nga inspektorët e inspektimit fito-sanitar në pikën e inspektimit kufitar. Inspektimi ka për qëllim të verifikojë nëse ky material është i vulosur sipas pikës 5, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi.

2. Në rast kur ngarkesa nuk është objekt inspektimi fito-sanitar, por është shoqëruar me material paketimi që plotëson dispozitat e nenit 5, kreu II, të këtij udhëzimi, doganieri njofton inspektorët e inspektimit fito-sanitar në PIK për të bërë inspektimin e materialit të paketimit prej druri sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Për ngarkesat që lëvizin tranzit dhe që shoqërohen me material paketimi prej druri që nuk janë të vulosura sipas pikës 5, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi, inspektori i inspektimit fito-sanitar në PIK, zbaton masat e përcaktuara në pikën 1, neni 18, të këtij kreu.

4. Inspektimi në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, bëhet me bazë risku.

Neni 18

Masat fito-sanitare në kundërvajtje me këtë udhëzim

1. Kur materiali i paketimit prej druri nuk është trajtuar dhe/ose vulosur sipas këtij udhëzimi, fillimisht kryhet bllokimi, ndërkohë që situata adresohet më pas, sipas nevojës merre masat si vijon:

a) heqjen e materialit të paketimit prej druri që nuk është trajtuar ose vulosur sipas këtij udhëzimi, ose;

b) trajtimin e materialit të paketimit prej druri që nuk është i trajtuar sipas këtij udhëzimi, ose;

c) shkatërrimin, e materialit të paketimit prej druri që nuk është trajtuar dhe vulosur sipas këtij udhëzimi, ose;

d) kthimin e ngarkesës në vendin e origjinës.

Në aneksin III, të këtij udhëzimi, janë dhënë metodat që mund të referohen për MAD të cilat nuk janë trajtuar dhe/ose vulosur sipas këtij udhëzimi.

2. Kur materiali i paketimit prej druri në import nuk mban vulën sipas pikës 5, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi ose kur zbulohet prania e parazitëve që tregojnë se trajtimi mund të mos ketë qenë

efektiv inspektori i inspektimit fito-sanitar në PIK, merr një nga masat e përshkruara sipas pikës 1, të këtij neni.

3. Në raste kur një njësi e materialit të paketimit prej druri mban më shumë se një vulë inspektori, inspektimi fito-sanitar në PIK duhet të përcaktojë origjinën e njësisë e cila nuk është sipas këtij udhëzimi, nëse ka, para se ta dërgojë njoftimin për mospërputhje të SPMB-ja.

4. Inspektori i inspektimit fito-sanitar në PIK menjëherë pas konstatimit të problematikës të përshkruar në pikën 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të njoftojë SPMB-në. SPMB-ja pas marrjes së njoftimit, njofton vendin eksportues ose vendin e prodhimit nëse është i përfshirë, në rastet kur ka praninë e parazitëve të gjallë.

5. Kur materiali i paketimit prej druri nuk mban vulën sipas pikës 4, neni 10, kreu IV, të këtij udhëzimi ose kur zbulohet prania e parazitëve që tregon se trajtimi mund të mos ketë qenë efektiv, shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, që mbulon rajonin, duhet të ndërmarrë një nga masat e përshkruara sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 19 Shfuqizime

Udhëzimi nr. 7, datë 27.2.2007, “Për miratimin e rregullave mbi sigurinë fito-sanitare të materialit ambalazh prej druri që qarkullon në tregtinë ndërkombëtare dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI I

TRAJTIMET E MIRATUARA PËR MATERIALIN E PAKETIMIT PREJ DRURI

Trajtimet e miratuara aplikohen në njësitë e materialit të paketimit prej druri ose në pjesë të drurit që do të përdoret për këtë qëllim.

Përdorimi i drurit me lëvore

Pavarësisht llojit të trajtimit të aplikuar, materiali i paketimit prej druri mund të përbëhet nga druri me lëvore. Për këtë udhëzim, çdo numër pjesësh të vogla, vizualisht të veçuara dhe qartësisht të ndara të lëvres mund të qëndrojnë të tilla nëse janë:

- a) më pak se 3 cm në gjerësi, pavarësisht nga gjatësia, ose;
- b) më shumë se 3 cm në gjerësi, me një sipërfaqe totale të një pjese të lëvres më pak se 50 cm².

Për trajtimet me methyl bromide dhe sulphuryl fluoride, heqja e lëvres duhet të bëhet para trajtimit meqë prania e lëvres në dru mund të ndikojë në efikasitetin e trajtimit.

Për trajtimet me nxehtësi, heqja e lëvres mund të bëhet përpara ose pas trajtimit. Kur një kufizim përmasash specifikohet për një lloj të caktuar të trajtimit me nxehtësi p.sh. nxehtësi dielektrike, çdo lëvore mund të përfshihet në matjet dimensionale.

Trajtimi me nxehtësi

Mund të përdoren burime të ndryshme energjie ose procesesh për të arritur parametrat e kërkuar të trajtimit. Për shembull, nxehtësia konvencionale me avull, tharja në furrë, nxehtësia e arritur nga ngopja e presionit kimik dhe nxehtësia dielektrike (mikrovalë, radiofrekuencë), të gjitha mund të konsiderohen trajtime me nxehtësi që garantojnë arritjen e parametrave të trajtimit me nxehtësi të përshkruar në këtë udhëzim.

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, duhet të sigurojë që operatorët e miratuar të trajtimit, të monitorojnë temperaturën e trajtimit në një pikë që mund të jetë më e ftohtë, e cila do të jetë pika që do të marrë kohën më të gjatë për të arritur temperaturën e duhur në dru, e cila siguron që është mbajtur temperatura e duhur gjatë trajtimit për gjithë ngarkesën e drurit që është në proces trajtimi. Pika në të cilën një copë druri është më e ftohtë mund të variojë bazuar në burimin e energjisë ose procesin e aplikuar, përmbajtjes së lagështirës dhe temperaturës fillestare në dru.

Kur përdoret nxehja dielektrike si burim nxehtësie, pjesa më e ftohtë e drurit gjatë trajtimit është zakonisht sipërfaqja. Në disa situata p.sh. nxehja dielektrike e drurëve të përmasave të mëdha që janë ngrirë dhe deri në momentin e shkrirjes, mund të jetë bërthama pjesa më e ftohtë e drurit.

Trajtimi me nxehtësi duke përdorur një avull konvencional ose tharje në dhoma furrë (kodi i trajtimit për vulën: HT)

Kur përdoret teknologjia konvencionale e dhomave me nxehtësi, kërkesa themelore është të arrihet një minimum temperature prej 56 OC për një minimum kohor prej 30 minutash të vazhdueshme, gjatë gjithë profilin të drurit duke përfshirë dhe bërthamën e tij.

Kjo temperaturë mund të matet duke futur sensor temperature në bërthamën e drurit. Në të kundërt, kur përdoren furra tharjeje me nxehtësi ose dhoma të tjera të trajtimeve me nxehtësi, plani i trajtimit duhet të bëhet mbi bazën e një serie testesh trajtuese gjatë të cilave temperatura e bërthamës së drurit në pika të ndryshme brenda dhomës matet dhe përshtatet me temperaturën e ajrit të dhomës, duke marrë parasysh përmbajtjen e lagështisë në dru dhe parametrave të tjerë të rëndësishëm siç është lloji ose trashësia e drurit, shkalla e qarkullimit të ajrit dhe lagështia. Seria e testimit duhet të demonstrojë një minimum temperature prej 56 OC, i cili mbahet për një minimum kohor prej 30 minutash të vazhdueshme, gjatë gjithë profilin të drurit.

Operatorët të cilët kërkojnë të pajisen me miratim nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, për të kryer këtë proces trajtimi duhet të marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm që kërkojnë për një dhomë me nxehtësi, për të përmbushur kërkesat e trajtimit, siç janë:

a) dhoma e nxehtësisë duhet të jetë e mbyllur dhe e izoluar termikisht, duke përfshirë edhe izolimin e dyshemesë;

b) dhoma e nxehtësisë dizajnohet në një mënyrë të tillë që lejon qarkullimin e ajrit në mënyrë uniforme rreth e rrotull grumbullit të drurëve. Drurët që do të trajtohet sistemohet në dhomë në mënyrë të tillë që të sigurojë qarkullim të mirë të ajrit rreth e rrotull grumbullit të drurëve;

c) ventilatorët e ajrit në hapësirën e dhomës dhe ndarjeve të grumbujve të drurëve vendosen në mënyrë që të sigurojnë një qarkullim të përshtatshëm të ajrit;

d) ventilatorët duhen të përdoren për të bërë qarkullimin e ajrit gjatë trajtimit dhe ajri që rrjedh nga këta ventilatorë është i mjaftueshëm për të siguruar që temperatura e bërthamës së drurit të mbahet në nivelet e specifikuara gjatë kohëzgjatjes së kërkuar;

e) pika më e ftohtë brenda dhomës identifikohet për çdo ngarkesë dhe vendosen sensorë temperature, si në dru ashtu edhe në dhomë;

f) kur temperatura e trajtimit monitorohet duke përdorur sensorë temperature të futur brenda në dru, rekomandohen të paktën dy sensorë temperature. Këta sensorë duhet të jenë të përshtatshëm për të matur temperaturën e bërthamës së drurit. Përdorimi i shumëfishtë i sensorëve të temperaturës siguron zbulimin e çdo dështimi të sensorëve të temperaturës gjatë procesit të trajtimit. Sensorët e temperaturës vendosen të paktën 30 cm nga fundi i çdo pjese të drurit dhe shtyhen për në qendër të tij. Dhe për dërrasa ose blloqe paletash më të shkurtra, sensorët e temperaturës vendosen në ato pjesë druri me përmasa më të mëdha në mënyrë që të sigurojnë matjen e temperaturës në bërthamë. Çdo vrimë e hapur në drurët ku do të vendosen sensorët e temperaturës duhet të mbyllet me material të përshtatshëm për të ndaluar humbjet/ndërhyrjet në matjen e temperaturës nëpërmjet

nxehtësisë ose përçimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndikimeve të jashtme në dru siç janë gozhdët ose metalet të futura që mund të çojnë në matje të gabuara;

g) kur plani i trajtimit bazohet në monitorimin e temperaturës së ajrit në dhomë dhe përdoret për trajtimin e llojeve të ndryshme të drurëve p.sh. llojeve dhe përmasa specifike, planet, marrin parasysh llojin, përmbajtjen e lagështisë dhe trashësinë e drurit që do të trajtohet. Rekomandohen të paktën dy sensorë temperature për monitorimin e temperaturës së ajrit në dhomën trajtuese të drurit të paketimit sipas planeve trajtuese;

h) nëse rrjedhja e ajrit në dhomë kthehet në mënyrë rutinore gjatë trajtimit, mund të lindë nevoja për një numër më të madh sensorësh temperature për të marrë parasysh ndryshime të mundshme të vendndodhjes së pikës më të ftohtë;

i) sensorët e temperaturës dhe pajisjet e tjera matëse kalibrohen në përputhje me instruksionet e prodhimit sipas një frekuence të specifikuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së;

j) temperatura monitorohet dhe regjistrohet gjatë çdo trajtimi për të siguruar që temperatura minimale e përshkruar është mbajtur gjatë periudhës kohore të kërkuar. Nëse temperatura minimale nuk është mbajtur, është e nevojshme të ndërmerren veprime korrigjuese për të siguruar që të gjithë drurët janë trajtuar sipas temperaturës së kërkuar, 30 minuta të vazhdueshme në 56 °C , p.sh, trajtimi rifillon ose zgjatet koha e trajtimit dhe, nëse është e nevojshme, rritet temperatura. Gjatë periudhës së trajtimit, frekuenca e leximit të temperaturës është e mjaftueshme për të siguruar zbulimin e dështimeve të trajtimit;

k) për qëllime kontrolli nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB- së operatorët e miratuar mbajnë shënime mbi trajtimet me nxehtësi dhe kalibrimet për një periudhë kohore 3 vjet.

Trajtimi me nxehtësi duke përdorur nxehtjen dielektrike (kodi i trajtimit për vulën: DH)

Kur përdoret nxehtja dielektrike mikrovalë ose përçues vale, materialet e paketimit prej druri duhet të nxehten për të arritur një minimum temperature prej 60 °C për 1 minutë, gjatë gjithë profilin të drurit duke përfshirë edhe sipërfaqen e tij. Subjektet e këtij trajtimi me nxehtësi dielektrike duhet të verifikojë nëse planet e tyre përmbushin parametrat specifike të kërkuar duke marrë parasysh përmbajtjen e lagështisë në dru, përmasat dhe dendësinë e tij dhe frekuencën e mikrovalëve ose përçuesve të valëve.

Operatorët të cilët kërkojnë të pajisen me miratim nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, për të kryer këtë proces trajtimi duhet të marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm që kërkojnë për një dhomë nxehtësi dielektrike, për të përmbushur kërkesat e trajtimit, siç janë:

a) Pavarësisht nëse nxehtja dielektrike kryhet si një proces i grumbullit ose si një proces në vazhdimësi, trajtimi monitorohet në dru ku temperatura është më e ulët, normalisht në sipërfaqe, për t'u siguruar që është mbajtur temperatura që kërkohej. Për matjen e temperaturës rekomandohen të paktën dy sensorë temperature për të siguruar që zbulohet çdo çrregullim i sensorëve të temperaturës;

b) subjekti i trajtimit ka vërtetuar fillimisht që temperatura e drurit arrin ose kalon 60 °C për 1 minutë gjatë gjithë profilin të drurit përfshirë sipërfaqen e tij;

c) për drurë që kalojnë 5 cm trashësi, nxehtja dielektrike në 2.45 GHz kërkon aplikim dy drejtimesh ose përçues të valëve shumëfishë për të shpërndarë energjinë e mikrovalëve dhe për të siguruar uniformitetin e nxehtësisë;

d) sensorët e temperaturës dhe pajisjet e mbajtjes së të dhënave janë kalibruar në përputhje me instruksionet e prodhimit në një frekuencë të specifikuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së;

e) për qëllime kontrolli nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, operatorët e miratuar mbajnë shënime mbi trajtimet me nxehtë dielektrike dhe kalibrimet për një periudhë kohore 3 vjet.

Trajtimi me methyl bromide (kodi i trajtimit për vulën: MB)

Duke ju referuar pikës 5, neni 19, kreu V, të ligjit nr. 105/ 2016, datë 27.10.2016 “Për mbrojtjen e bimëve” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Rregullat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve, që përmbajnë këto substanca” ku miratimi i lëndëve vepruese bëhet me Urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë, në përputhje me legjislacionin e BE-së. Referuar këtij Urdhri për miratimin e lëndëve vepruese *methyl bromide* nuk është i miratuar, pasi edhe në BE kjo lëndë vepruese është hequr. Për këtë arsye shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së, nuk mund të miratojë dhe të lejojë trajtim me *methyl bromide*.

Trajtimi me sulphuryl fluoride (kodi i trajtimit për vulën: SF)

Materiali i paketimit prej druri, që përmban një copë druri që kalon 20 cm në prerje tërthore në përmasat më të vogla të tij nuk duhet të trajtohet me sulphuryl fluoride. Materialet e paketimit prej druri me një përmbajtje lagështie më të lartë se 75% bazë të thatë nuk duhet të trajtohet me *sulphuryl fluoride*.

Fumigimi (tymosja) i materialit të paketimit prej druri me sulphuryl fluoride duhet të bëhet në përputhje me një plan të specifikuar ose të aprovuar që arrin një CT5 mbi 24 ose 48 orë në temperaturën që kërkohet dhe përqendrimi final i mbetur i specifikuar në Tabelën 3. Kjo CT duhet të arrihet gjatë gjithë profilin të drurit, përfshirë bërthamën e tij pavarësisht se përqendrimi matet në atmosferën e ambientit. Mund të lejohen rritje të vogla të kohës së trajtimit (jo më shumë se dy orë) për të arritur CT e kërkuar, nëse nuk është arritur përqendrimi final minimal. Temperatura minimale e drurit nuk duhet të jetë më pak se 20 °C dhe koha minimale e ekspozimit nuk duhet të jetë më pak se koha e përcaktuar për çdo temperaturë në Tabelën 3. Monitorimi i përqendrimit të gazit duhet të kryhet minimalisht 2, 4, 24 dhe kur është e përshtatshme, 48 orë nga fillimi i trajtimit. Në rastet kur kemi kohë më të gjatë ekspozimi dhe përqendrim të dobët, duhet të kryhen matje shtesë të përqendrimit të gazit në fund të fumigimit (tymosja).

Nëse nuk arrihet CT brenda një periudhe të vetme 24 ose 48 orësh, edhe nëse arrihet përqendrimi final minimal, duhet të ndërmerren veprime korrigjuese. Koha e trajtimit mund të zgjatet maksimumi dy orë pa shtuar më tepër sulphuryl fluoride ose mund të rifillojë procesi.

Tabela 3. CT minimale e kërkuar gjatë 24 ose 48 orëve për materialet e paketimit prej druri fumiguar(tymosur) me sulphuryl fluoride.

Temperatura (°C)	CT minimale e kërkuar (g·h/m ³)	Përqendrimi final minimal (g/m ³)†
30 ose më shumë për 24 h	1400	41
20 ose më shumë për 48 h	3000	29

Nëse nuk arrihet përqendrimi final minimal pas 24 ose 48 orëve në fund të trajtimit lejohej një devijim në përqendrim prej ~5% nëse shtohet koha e trajtimit në fund të trajtimit për të arritur CT e përcaktuar.

Në tabelën 4 tregohet shembulli i një plani që mund të përdoret për të arritur kërkesat e specifikuar.

Tabela 4. Shembull i një plani trajtimi që arrin CT minimale të kërkuar për materialet e paketimit prej druri të trajtuara me sulphuryl fluoride doza fillestare mund të jetë më e lartë në përqëndrime të thithjes ose në qarkullim.

Temperatura (°C)	CT minimale e kërkuar (g·h/m ³)	Doza (g/m ³)	Përqendrimi minimal (g/m ³) në:						
[166]	[167]	[168]	0.5 h	2 h	4 h	12 h	24 h	36 h	48 h
30 ose më sipër	1400	82	87	78	73	58	41	n/a	n/a
20 ose më sipër	3000	120	124	112	104	82	58	41	29

n/a, nuk aplikohet.

Operatorët të cilët kërkojnë të pajisen me miratim nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, për të kryer këtë proces trajtimi duhet të marrin në konsideratë faktorët e mëposhtëm që kërkojnë për të arritur kërkesat e trajtimit me fumigim me *sulphuryl fluoride*, siç janë:

a) përdoren ventilatorë gjatë fazës së shpërhapjes së gazit të fumigimit (tymosjes) për të siguruar shpërhapjen sa më uniform, vendosen në mënyrë të përshtatshme për të garantuar shpërhapje të shpejtë dhe efektive të fumigimit (tymosjes) në të gjithë fumigimet (tymosjet) e mbyllura preferohet brenda orës së parë të aplikimit;

b) fumigimet (tymosjet) e mbyllura nuk mbushen përtej 80% të vëllimit të tij/saj;

c) fumigimet (tymosjet) e mbyllura mbyllen shumë mirë si impiant gazi. Nëse fumigimi (tymosja) duhet të kryhet nën fletë këto duhet të jenë të përbëra nga material gaz-durues dhe duhet të jenë të mbyllura mirë në lidhjet dhe në nivelin e dyshemesë;

d) shtresa përdhese e fumigimit (tymosjes) duhet të jetë e papërshkueshme nga fumigantët, nëse nuk është e tillë atëherë shtresa gaz-duruese shtrohet në dysheme;

e) grumbulli i drurëve kanë nevojë për ndarje të paktën çdo 20 cm për të siguruar qarkullim dhe penetrim të përshtatshëm të *sulphuryl fluoride*;

f) kur llogaritet doza e *sulphuryl fluoride*, bëhet kompensimi për çdo përzjerje gazi p.sh. dioksid karboni për të siguruar që sasia totale e fumigantit të pastër, arrin kërkesat e përshkruara në këtë udhëzim;

g) përqendrimi i *sulphuryl fluoride* në ajrin e hapësirës matet gjithmonë në pikën më të largët nga pika hyrëse e gazit ashtu sikurse edhe në pika të tjera përgjatë mbylljes p.sh. në pjesën e përparme, në qendrën dhe mbrapa dhe lart për të konfirmuar që është arritur shpërndarje uniforme e gazit. Koha e trajtimit nuk llogaritet pa u arritur shpërndarja uniforme;

h) normat fillestare të dozës dhe procedurat e trajtimit pas trajtimit, merren parasysh burimet e mundshëm të bllokimit të *sulphuryl fluoride* nga materiali i ambalazhimit të trajtuar ose produkti përkatës p.sh. kutitë e polistirenit;

i) temperatura e matur e materialit ose e ajrit të ambientit i cili gjithmonë është më i ulët, përdoret për të llogaritur dozën e *sulphuryl fluoride* dhe temperatura e produktit duhet të jetë të paktën 20°C duke përfshirë bërthamën e drurit, gjatë gjithë kohës së trajtimit;

j) materiali i paketimit prej druri që do të fumigohet (tymoset) nuk ambalazhohet ose mbështillet me materiale të papërshkueshme nga fumigantët;

k) sensorët e temperaturës dhe të përqendrimit të gazeve dhe pajisjet për mbledhjen e të dhënave kalibrohen në përputhje me udhëzimet e prodhuesit në një frekuencë të specifikuar nga Shërbimi i

Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së. Pajisjet që përdoren për matjen e përqendrimit të *sulphuryl fluoride* mund të ndikohen nga lartësia, avujt e ujit, dioksidi i karbonit ose temperatura. Këto pajisje kanë nevojë të kalibrohen specifikisht për *sulphuryl fluoride*;

l) për qëllime kontrolli nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, operatorët e miratuar mbajnë shënime mbi fumigimet (tymosjet) me *sulphuryl fluoride* dhe kalibrimet për një periudhë kohore 3 vjet ARSHVMB-së;

m) personeli që aplikon trajtimin me fumigim (tymosje) duhet të ndjekë kërkesat e etiketës së përdorimit të *sulphuryl fluoride*.

ANEKSI II

VULA DHE APLIKIMET E SAJ

Një vulë, që tregon se materiali i paketimit prej druri ka qenë objekt i trajtimeve fito-sanitare të miratuara në përputhje me këtë udhëzim, duke përfshirë komponentët e kërkuar siç paraqiten më poshtë:

- a) simbolin;
- b) një kod të vendit;
- c) një kod të prodhuesit/ operatorit të miratuar;
- d) një kod të trajtimit duke përdorur shkurtesën e duhur sipas aneksit 1 (HT, DH, MB ose SF).

Simboli

Dizajni i simbolit i cili është regjistruar sipas procedurave kombëtare, si një vulë tregtare ose si një vulë certifikimi/kolektive/garancie duhet të jetë siç tregohet në shembullin e ilustruar më poshtë dhe duhet të jetë në të majtë të të gjithë përbërësve të tjerë.

Kodi i vendit

Kodi i vendit në shembull tregohet si “XX”, ku është zbatuar kjo masë e aprovuar fito-sanitare p.sh. kur trajtimi fito-sanitar bëhet në Shqipëri sipas këtij udhëzimi vendosen inicialet –AL, kur vijnë nga vendet e tjera ku është zbatuar një nga masat të përshkruar në këtë udhëzim p.sh. nga Itali-IT, etj. Ai duhet të jetë i ndarë nga një vijë ndarëse nga kodi i prodhuesit/trajtimit.

Kodi i prodhuesit/operatorit të miratuar

Kodi i prodhuesit/operatorit të miratuar është një kod unik i caktuar nga SPMB-ja për operatorin e miratuar i cili mund të bëjë të gjitha proceset ose i cili mund t'i bëjë në subjekte të ndryshëm, si prodhimin dhe trajtimin duke e dokumentuar me një marrëveshje ndërmjet palëve. Në çdo rast operatori i miratuar do jetë vetëm ai i cili aplikon vulën dhe është përgjegjës për plotësimin e kriterëve të përshkruara në këtë udhëzim i cili miratohet dhe kontrollohet nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së për të siguruar që përdoret dru i trajtuar dhe vulosur siç duhet; i cili tregohet si në “000” te shembulli. Numri dhe rendi i shifrave dhe/ose shkronjave përcaktohet nga SPMB-ja, pas kërkesës të bërë nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së.

Kodi i trajtimit

Kodi i trajtimit është një shkurtim IPPC (Konventa Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Bimëve) siç jepet në aneksin I për masat e miratuara në këtë udhëzim që zbatohen nga operatori i miratuar vendas (në shembull tregohet si “YY”). Kodi i trajtimit duhet të shfaqet pas kodit të vendit dhe prodhuesve/subjekteve të trajtimit i ndarë nga një vijë ndarëse nëse vendoset në të njëjtën linjë me kodet e tjerë.

Kodi i trajtimit	Lloji i trajtimit
HT	Trajtimi me nxehtësi
DH	Nxehja dielektrike

MB	Methyl bromide
SF	Sulphuryl fluoride

Aplikimi i vulës

Madhësia, lloji i shkrimit të përdorur dhe pozicioni i vulës mund të ndryshojë por madhësia e saj duhet të jetë e mjaftueshme për të qenë e dukshme dhe e lexueshme gjatë inspektimeve përdorur një vizualizues shtesë. Vula duhet të jetë në formë drejtkëndore ose katrore dhe të përmbajë një vijë kufizuese vertikale që ndan simbolin nga kodet përbërës. Për të lehtësuar përdorimin e një klisheje, mund të jenë të pranishme hapësira të vogla në vijën ndarëse, vijën vertikale dhe kudo tjetër në përbërësit e vulës.

Asnjë informacion tjetër nuk duhet të përfshihet brenda kufijve të vulës. Nëse vula shtesë p.sh. vula tregtare e prodhuesit, logoja e trupit autorizues, konsiderohen të dobishme për të mbrojtur vulën në një nivel kombëtar, ku informacion mund të lejohet afër por jashtë kufirit të vulës.

Vula duhet të jetë:

- e lexueshme,
- rezistente dhe e patransformueshme,
- e vendosur në një vend i cili është i dukshëm kur përdoret druri për paketim, preferohet në të paktën dy anët e kundërta të njësisë së paketimit prej druri.

Vula nuk duhet të jetë e vizatuar me dorë. Përdorimi i ngjyrave të kuqe dhe portokalli nuk lejohet, pasi këto ngjyra përdoren në etiketat e mallrave të rrezikshme. Kur operatori i miratuar, përfshin në një proces subjekte të tjerë duke lidhur një marrëveshje mes palëve p.sh. me subjektin e prodhimit dhe/ose subjektin e trajtimit; për materialin e paketimit prej druri, njësia përgjegjëse për plotësimin e kriterëve dhe procesin e vulosjes sipas këtij udhëzimi duhet të jetë operatori i miratuar. Te materiali i paketimit prej druri të përbërë si nga dru i përpunuar ashtu dhe nga material druri i procesuar (kur përbërësi i procesuar nuk kërkon trajtim), mund të jetë më e përshtatshme që vula të vendoset te përbërësit e procesuar të materialit prej druri për të siguruar që vula është në një vend të dukshëm dhe është e një madhësie të mjaftueshme. Kjo qasje ndaj aplikimit të vulave zbatohet vetëm ndaj njësisë unike të përbëra, jo ndaj montimeve të përkohshme të materialeve të paketimit prej druri. Është e nevojshme një vëmendje e veçantë ndaj aplikimit të lexueshëm të vulës në materialet fiksuese sepse druri i trajtuar për t'u përdorur si material fiksues mund të mos pritët në gjatësinë përfundimtare derisa të kryhet ngarkimi i një ngarkese. Është e rëndësishme që transportuesit e mallrave të sigurojë që të gjithë materialet fiksuese të përdorura për të siguruar ose mbështetur ngarkesën janë trajtuar dhe mbajnë vulën; sipas këtij aneksi, dhe që vulat të jenë të qarta dhe të lexueshme. Pjesë të vogla druri që nuk përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar të vulës nuk duhet të përdoren për materialin fiksues.

Mundësi për vulosjen e materialit fiksues siç duhet:


- aplikimi i vulës në pjesët e drurit që pretendohet të përdoret si material fiksues, gjatë gjithë gjatësisë së tij në intervale shumë të shkurtra shënim: ku pjesë shumë të vogla janë prerë më pas për përdorim si material fiksues, prerjet duhen bërë në mënyrë të tillë që një vulë e plotë të jetë e pranishme në materialet fiksues që do përdoren.

- aplikime shtesë të vulës në materialet fiksuese të trajtuara në vende të dukshme pas prerjes.


Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë disa variante të pranueshme të përbërësve të kërkuar të vulës e cila përdoret për të certifikuar që materiali i paketimit prej druri që mban këtë vulë ka qenë objekt i një trajtimi të miratuar sipas këtij udhëzimi. Nuk duhet të pranohen ndryshime në simbol. Ndryshimet në paraqitjen e vulës mund të pranohen nëse ato përputhen me kërkesat e paraqitura në këtë udhëzim.

1. Inspektori fito-sanitar në PIK, duhet të lejojë në import vetëm materialin e paketimit prej druri të vulosura me model vule sipas shembullit 1, deri në shembullin 6, siç janë përshkruar më poshtë:


Shembulli 1




Shembulli 2



Shembulli 3 (Kjo paraqet një shembull të mundshëm të vulës me kufij me kulme të rrumbullakosur)




Shembulli 4 (Kjo paraqet një shembull të mundshëm të një vule duke aplikuar klisheet; hapësira të vogla mund të jenë prezente në kufij, dhe në linjën vertikale dhe kudo tjetër përgjatë përbërësve të vulës)



Shembulli 5




Shembulli 6



2. Për materialin e paketimit prej druri të cilat i nënshtrohen procesit të vulosjes në Shqipëri duhet që:

Operatori i miratuar të përdori vulë sipas modelit të mëposhtëm:



ANEKSI III

METODAT E ZBATUARA NË RASTET E KONTROLLIT TË MATERIALEVE TË PAKETIMIT PREJ DRURI QË NUK JANË TRAJTUAR DHE VULOSUR SIPAS KËTIJ UDHËZIMI

Masat e listuara më poshtë rekomandohen të ndiqen në rastet kur MPD-ja nuk është trajtuar dhe vulosur sipas këtij udhëzimi; këto masa janë:

- djegia, nëse lejohet;
- groposja e thellë në pika të miratuara shpjegim: *thellësia e groposjes mund të varet nga kushtet klimaterike dhe nga paraziti i zbuluar, por rekomandohet të jetë të paktën 2 metra. Materiali duhet të mbulohet menjëherë pas groposjes dhe duhet të mbahet i groposur. Përmendet, gjithashtu, që groposja e thellë nuk është një alternativë e përshtatshme për kontrollin e drurëve të infektuar me milingonat (termites) “*Isoptera*” ose disa patogjenet e rrënjëve);*
- procesimi, shpjegim: *ciflosja mund të kryhet vetëm nëse kombinohet me procesim të mëtejshëm në një mënyrë të miratuar nga SPMB-ja, për eliminimin e dëmtuesve e shqetësimit, p.sh. prodhimi si fije dërrase;*
- metoda të tjera të miratuara për kontrollin e parazitëve;
- kthim në vendin eksportues, nëse është e përshtatshme.

Për të minimizuar riskun e hyrjes dhe përhapjes së dëmtuesve, kur kërkohet duhet të ndërmerren metoda të kontrollit të sigurt sa më shpejt të jetë e mundur.

ANEKSI IV



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA RAJONALE E SHËRBIMIT VETERINAR
DHE MBROJTJES SË BIMËVE _____

Nr. _____ prot. Tiranë, më datë _____.____.202__

FORMULARI I MIRATIMIT TË OPERATORIT PËR TRAJTIMIN E MATERIALIT TË PAKETIMIT PREJ DRURI

A. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË OPERATORIT

1	EMRI I OPERATORIT	
2	KONTAKTI	
3	ADRESA	
4	PRODHUESI	
5	TRAJTUESI	

* Nëse një ose të dy proceset, si prodhimi dhe trajtimi nuk i bën operatori i miratuar ai duhet të shkruajë te tabela emrin e subjektit të prodhimit dhe trajtimit, respektivisht te pika 4 dhe 5.

B. OPERATORI KËRKON TË MIRATOHET PËR TË KRYER PROCESIN E TRAJTIMIT ME:

1. Nxehtësi (HT) ☐ (shko në pikën C 1) 2. Nxehtësi Dielektrike ☐ (shko në pikën C 2)
3. Sulphuryl fluoride ☐ (shko në pikën C 3)

* operatori miratohet vetëm për një nga proceset e trajtimit gjatë një kontrolli.

C. NGA KONTROLLI U KONSTATUA

Baza ligjore: Ligji nr. 105/2016 “Për Mbrojtjen e Bimëve”, udhëzimi nr.____, datë____.____, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
Kërkesat		Plotësimi i kushteve	
		PO	JO N/A

1. Trajtimi me nxehtësi (HT)			
a) dhoma e nxehtësisë duhet të jetë e mbyllur dhe e izoluar termikisht, duke përfshirë edhe izolimin e dyshemesë;			
b) dhoma e nxehtësisë është e dizajnuar në një mënyrë të tillë që lejon qarkullim e ajrit në mënyrë uniforme rreth e rrotull grumbullit të drurëve. Drurët që do të trajtohet sistemohet në dhomë në mënyrë të tillë që të sigurojë qarkullim të mirë të ajrit rreth e rrotull grumbullit të drurëve;			
c) ventilatorët e ajrit në hapësirën e dhomës dhe ndarjeve të grumbujve të drurëve janë vendosur në mënyrë që të sigurojnë një qarkullim të përshtatshme të ajrit;			
d) ventilatorët janë vendosur në një mënyrë që bëjnë të mundur qarkullimin e ajrit gjatë trajtimit;			
e) është identifikuar pika më e ftohtë brenda dhomës për çdo ngarkesë dhe vendosen sensorë temperature si në dru ashtu edhe në dhomë;			
f) temperatura e trajtimit është monitoruar duke përdorur sensorë temperature të futur brenda në dru, rekomandohen të paktën dy sensorë temperature. Çdo vrimë e hapur në drurë ku do të vendosen sensorët e temperaturës duhet të mbyllet me material të përshtatshëm për të ndaluar humbjet/ndërrhyrjet në matjen e temperaturës nëpërmjet nxehtësisë ose përcimit;			
g) në rast rrjedhje të ajrit në dhomë përsëritet gjatë trajtimit, mund të lindë nevoja për një numër më të madh sensorësh temperature për të marrë parasysh ndryshime të mundshme të vendndodhjes së pikës më të ftohtë;			
h) sensorët e temperaturës dhe pajisjet e tjera matëse janë të kalibruar në përputhje me instruksionet e prodhimit, sipas një frekuence të specifikuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së.			
2. Trajtimi me nxehtësi dielektrike (DH)			
a) edhe nëse nxehtësia dielektrike kryhet si një proces grumbull ose si një proces në vazhdimësi, trajtimi monitorohet në dru ku temperatura është më e ulët, normalisht në sipërfaqe, për t'u siguruar që është mbajtur temperatura që kërkohet;			
b) temperatura e drurit duhet të arrijë ose të kalojë 60 °C për 1 minutë gjatë gjithë profilin të drurit përfshirë sipërfaqen e tij;			
c) nëse lënda drusore kalon 5 cm trashësi, nxehtësia dielektrike në 2.45 GHz kërkon aplikim dydrejtimesh ose përcues të valëve shumëfishe për të shpërndarë energjinë e mikrovalëve dhe për të siguruar uniformitetin e nxehtësisë;			
d) sensorët e temperaturës dhe pajisjet e mbajtjes e të dhënave duhen të jenë të kalibruar në përputhje me instruksionet e prodhimit në një frekuencë të specifikuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së.			
3. Trajtimi me sulphuryl fluoride (SF)			
a) duhet të përdoren ventilatorë gjatë fazës së shpërhapjes së gazit të fumigimit (tymosjes) për të siguruar shpërhapjen sa më uniforme;			
b) fumigimet (tymosjet) e mbyllura nuk duhet të mbushen përtej 80% të vëllimit të tij/saj;			
c) fumigimet (tymosjet) e mbyllura duhen të mbyllen shumë mirë si impiant gazi. Nëse fumigimi (tymosja) duhet të kryhet nën fletë këto duhet të jenë të përbëra nga material gaz-durues;			
d) shtresa përdhese e fumigimit (tymosjes) duhet të jetë e papërshkueshme nga fumigantet, nëse nuk është e tillë atëherë shtresa gaz-duruese shtrohet			

në dysheme;			
e) grumbulli i drurëve kanë nevojë për ndarje të paktën çdo 20 cm për të siguruar qarkullim dhe penetrim të përshtatshëm të sulphuryl fluoride;			
f) llogaritja e dozës të sulphuryl fluoride, bëhet kompensimi për çdo përzierje gazi p.sh. dioksid karboni për të siguruar që sasia totale e fumigantit të pastër, duhet të arrijë kërkesat e përshkruara në këtë udhëzim;			
g) përqendrimi i sulphuryl fluoride në ajrin e hapësirës matet gjithmonë në pikën më të largët nga pika hyrëse e gazit ashtu sikurse edhe në pika të tjera përgjatë mbylljes;			
h) normat fillestare të dozës dhe procedurat e trajtimit pas trajtimit, duhet të merren parasysh burimet e mundshëm të bllokimit të sulphuryl fluoride nga materiali i ambalazhimit të trajtuar ose produkti përkatës p.sh. kutitë e polistirenit;			
i) temperatura e matur e materialit ose e ajrit të ambientit i cili gjithmonë është më i ulët, duhet të përdoret për të llogaritur dozën e sulphuryl fluoride dhe temperatura e produktit duhet të jetë të paktën 20°C duke përfshirë bërthamën e drurit, gjatë gjithë kohës së trajtimit;			
j) materiali i paketimit prej druri që do të fumigohet (tymoset) nuk duhet të ambalazhohet ose mbështillet me materiale të papërshkueshme nga fumigantet;			
k) sensorët e temperaturës dhe të përqendrimit të gazeve dhe pajisjet për mbledhjen e të dhënave duhet të kalibrohen në përputhje me udhëzimet e prodhuesit në një frekuencë të specifikuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së. Pajisjet që përdoren për matjen e përqendrimit të sulphuryl fluoride mund të ndikohen nga lartësia, avujt e ujit, dioksidi i karbonit ose temperatura. Këto pajisje kanë nevojë të kalibrohen specifikisht për sulphuryl fluoride;			
l) për qëllime kontrolli nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve pranë ARSHVMB-së, duhet që operatorët e miratuar të mbajnë shënime mbi fumigimet (tymosjet) me sulphuryl fluoride dhe kalibrimet për një periudhë kohore 3 vjet ARSHVMB-së;			
m) personeli që aplikon trajtimin me fumigim (tymosje) duhet të ndjekë kërkesat e etiketës së përdorimit të sulphuryl fluoride.			

* **N/A** nuk është aplikuar

D. OPERATORI

1. Miratohet

☐

1.1 Kodi i operatorit të miratuar _____

2. Nuk miratohet

☐

E. KOMENTET

* Te pika “E”, agronomi në rast mosmiratimi duhet të bëjë komentet e arsyes e mosmiratimit dhe detyrat për të plotësuar.

F. DEKLARAT E OPERATORIT

* Në rastet kur operatori miratohet, duhet që te pika “F” të deklarojë marrjen e përgjegjësive që do prodhojë vulën sipas modelit të miratuar në pikën 2, aneksin II, të udhëzimit nr.____, datë _____, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së; dhe do zbatojë në çdo proces trajtimi, kushtet e përcaktuara sipas këtij udhëzimi.

* Në rastet kur operatori i miratuar ka bërë kërkesë për shtim filiali, operatori i miratuar te pika “F” duhet të deklarojë se do përdorë vulën që ka të miratuar herën e parë.

(_____)

* Emër, mbiemër, vula/firma

Agronomi

(_____)

ANEKSI V



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

**AGJENCIA RAJONALE E SHËRBIMIT VETERINAR
DHE MBROJTJES SË BIMËVE _____**

Nr. _____. prot.

Tiranë, më datë _____. _____. 202__

**RAPORT KONTROLI PËR OPERATORIN E MIRATUAR PËR TRAJTIMIN E
MATERIALIT TË PAKETIMIT PREJ DRURI**

A. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË OPERATORIT TË MIRATUAR:

1	OPERATORI I MIRATUAR	
2	KONTAKTI	
3	ADRESA	
4	PRODHUESI	
5	TRAJTUESI	
6	KODI	

B. PROCESET E TRAJTIMIT ME:

1. Nxehtësi (HT) ☐ shko në pikën C 1) 2. Nxehtësi dielektrike ☐ shko në pikën C 2)
3. Sulphuryl fluoride ☐ (shko në pikën C 3)

C. NGA KONTROLI U KONSTATUA:

Baza ligjore:			
Ligji i nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, udhëzimi nr.____, datë____. ____., “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
	Po	Jo	N/A
Furnizimi me lëndë drusore të papërpunuar			
Origjina e lëndës drusore të papërpunuar			
Është e pajisur me Certifikatë Fito-sanitare ose Pasaportë Bimore ose Certifikatë të Brendshme			
Lënda drusore është konform legjislacionit në fuqi për mjedisin			
1. Trajtimi me nxehtësi (HT)			
1.1 Dhoma e nxehtësisë është sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, aneksin I, të udhëzimit nr.____, datë____. ____., “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
1.2 Janë mbajtur shënime në regjistrin për çdo proces trajtimi dhe vulosje të bërë, sipas modelit.			
2. Trajtimi me nxehtësi dielektrike (DH)			
2.1 Dhoma e trajtimit me nxehtësi dielektrike është sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2, aneksin I, të udhëzimit nr.____, datë____. ____., “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
2.2 Janë mbajtur shënime në regjistrin për çdo proces trajtimi dhe vulosje të bërë, sipas modelit.			
3. Trajtimi me sulphuryl fluoride (SF)			
3.1 Dhoma e trajtimit me fumigim (tymosje) është sipas kushteve të përcaktuara			

në pikën 3, aneksin I, të udhëzimit nr.____, datë____.____, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
3.2 Janë mbajtur shënime në regjistrin për çdo proces trajtimi dhe vulosje të bërë, sipas modelit.			
4. Riparimi dhe riprodhimi i materialit të paketimit prej druri			
4.1 MAD duket që është riparuar më shume se një të tretën e njësisë			
4.2 Çdo njësi e shtuar duhet të jetë e trajtuar dhe vulosur sipas udhëzimit nr.____, datë____.____, “Për rregullat dhe masat për trajtimin e ambalazheve dhe paletave prej druri” të MBZHR-së.			
4.3 Të gjitha vulat e mëparshme të materiali i paketimit prej druri të riparuar janë hequr.			
5. Vula			
5.1 Vula përfshin simbolin e IPPC (në të majtë)			
5.2 Vula përfshin kodin e vendit			
5.3 Vula përfshin kodin e prodhuesit			
5.4 Vula përfshin kodin e trajtimit			
5.5 Vula përfshin vijë kufizuese vertikale që ndan simbolin dhe kodet përbërës			
5.6 Nuk ka as një informacion tjetër brenda kufirit të vulës			
5.7 Vula është e qartë dhe e lexueshme			
5.8 Vula është e përhershme			
5.9 Vula është e dukshme dhe mundësisht e vulosur në dy anët e kundërta			
5.10 Kopja e vulës sigurohet (shënim: shmangni përdorimin e kuq ose portokalli në vulë)			
5.11 Vula mbahet në vende të sigurta dhe përdoret vetëm nga personat e autorizuar			
Procedura standarde e operatorit të miratuar			
6.1 Procedura standarde e operatorit të miratuar është e kënaqshme			
7. Foto			
7.1 Fotografitë e marra			
7.2 Detajet e fotografisë			

Agronomi

(_____)

ANEKSI VI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA RAJONALE E SHËRBIMIT VETERINAR
DHE MBROJTJES SË BIMËVE _____

CERTIFIKATË MIRATIMI

Operator i miratuar

(emri, mbiemri)

Me adresë:

Miratohet për trajtim me _____

Afati i veprimtarisë: _____

